



REPUBLIKA E KOSOVËS  
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.15.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË SUHAREKËS  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndër marr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Suharekës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga, Evetar Zeqiri (Udhëheqës Ekipi), Edon Kabashi dhe Mujë Gashi.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	9
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	13
4 Qeverisja.....	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	29
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	32


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Suharekës për vitin 2014 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 16/10/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Komuna kishte bërë klasifikim të gabuar të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra/shërbime dhe subvencione e transfere vlerën 579,923€.

Nga kjo shumë totale, përveç klasifikimit të gabuar, 445,000€ ishin bërë pagesa të parregullta në llogari të donatorëve, bazuar vetëm në disa marrëveshje.

Komuna, nga fondet për investime kapitale kishte bërë pagesa të parregullta në llogari të donatorëve në vlerë prej 445,000€. Kjo vlerë është e përfshirë në totalin e shpenzimeve të keqklasifikuara (579,923€). Për këto pagesa, donatorët nuk kishin ofruar dëshmi relevante për justifikimin e shpenzimeve, si: faturë, situacion për progresin e punës, raport mbi numrin e punëtorëve të angazhuar, raport të punës/mbikëqyrjes e as ndonjë raport për pranimin final të punëve apo shërbimeve. Ne nuk ishim në gjendje të verifikonim nëse donatorët kishin përmbushur obligimet e tyre.


#### Theksimi i çështjes


Si *Theksim i çështjes*, dëshirojmë të përmendim faktin se Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm, pasi që numërimi vjetor i pasurive nuk ishte kryer për të konfirmuar plotësinë e tyre.

(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes)

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:





**Përgjigja nga Menaxhmenti – auditimi për 2014**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

## 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të Komunës së Suharekës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shpreh opinionin:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operacionale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditorit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e ndërmjetme të auditimit, ne

ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i Komunës (ZKA) dhe Zyrтари Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### Konkluzioni i përgjithshëm

Ne jemi përcaktuar për Opinion të Kualifikuar me Theksim të Çështjes sepse, edhe pse janë korrigjuar disa shifra në PVF, kanë mbetur gabime materiale që kanë të bëjnë me klasifikim të gabueshëm të shpenzimeve si investime kapitale dhe me plotësinë e pasurive. Të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm ishin përmbushur plotësisht.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Komuna kishte bërë klasifikim të gabuar të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra/shërbime dhe subvencione e transfere vlerën 579,923€. Nga kjo shumë totale, përveç klasifikimit të gabuar, 445,000€ ishin bërë pagesa të parregullta në llogari të donatorëve, bazuar vetëm në disa marrëveshje. Për këto pagesa, donatorët nuk kishin ofruar dëshmi relevante për justifikimin e shpenzimeve, si: faturë, situacion për progresin e punës, raport mbi numrin e punëtorëve të angazhuar, raport të punës/mbikëqyrjes e as ndonjë raport për pranimin final të punëve apo shërbimeve. Ne nuk ishim në gjendje të verifikonim nëse donatorët kishin përmbushur obligimet e tyre.

#### Theksimi i çështjes

Si Theksim i çështjes, dëshirojmë të përmendëm faktin se Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm, pasi që numërimi vjetor i pasurive nuk ishte kryer për të konfirmuar plotësinë e tyre. (SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes)

## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, e datës 16/10/2014, janë identifikuar tre rreziqe. Këto janë rreziqe të anomalive materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit. Një nga rreziqet e identifikuar që ka të bëjë me pagesat e palëve të treta, nuk është materializuar për shkak të rritjes së kontrolleve të brendshme që janë zbatuar nga Menaxhmenti.

Megjithatë, rreziqet në lidhje me klasifikimin e saktë të shpenzimeve dhe plotësinë e pasurive, kanë ndodhur, për shkak se Menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime të duhura për të adresuar rreziqet e paraqitura. Mungesa e veprimit ka rezultuar me Opinion të kualifikuar me Theksim të Çështjes siç paraqitet më lart në detaje në pjesën 2.1.

### Rreziku i identifikuar

**Çështja 1 - Keq klasifikimi material i shpenzimeve të Mallrave dhe Shërbimeve dhe Subvencioneve si Investime Kapitale -Prioriteti i lartë**

### Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Gjatë auditimit të ndërmjetëm ne kemi shqyrtuar kontrollet e Menaxhmentit dhe proceset shoqëruese që janë zbatuar për kapitalizimin e shpenzimeve si dhe kemi dhënë këshilla për t'i përmirësuar ato ashtu si duhet. Megjithatë, auditimi ynë përfundimtar identifikoi keq klasifikime prej 579,923€, shumë kjo materiale për PVF. Kjo ka ndodhur për shkak se Menaxhmenti nuk ka zbatuar kontrollet e duhura rreth planifikimit në nivelin e investimit kapital. Janë bërë vetëm disa përpjekje nga Komuna për ta adresuar këtë situatë me Ministrinë e Financave dhe për ta gjetur një zgjidhje që do të ndihmonte në klasifikimin e saktë të shpenzimeve. Një rishikim i yni i buxhetit të vitit 2015 ka treguar se një gjendje e njëjtë pritet të përsëritet edhe këtë vit.

**Rekomandimi 1** Për vitin 2015 Kryetari i Komunës të sigurojë një dialog të shtuar me Ministrinë e Financave për ta përcaktuar një zgjidhje të pranueshme për ta evituar keq klasifikimin material.

#### Rreziku i identifikuar

Çështja 2 – Pasuritë nën pronësi të komunës nuk janë numëruar në fund të vitit për të konfirmuar ekzistencën dhe plotësinë e pasurisë –Prioriteti i lartë

#### Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga Menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive. Në memo të auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla Menaxhmentit për veprimet që nevojiten për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të jetë e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë një numërim efektiv të inventarit të pasurive në fund vit. Megjithatë, janë ndërmarrë një sërë veprimesh pozitive për regjistrimin e blerjeve të vitit 2014 dhe dokumentacioni në lidhje me to është përmirësuar.

**Rekomandimi 2** Kryetari duhet ta prioritzojë kompletimin e një inventarizimi të tërësishëm në vitin 2015 për ta konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e shifrave të pasurive në PVF.

### 2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

#### Përshkrimi

Komuna e Suharekës duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore duke përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore;
- Raportet operative (të performancës); dhe
- Draft plani përfundimtar i prokurimit.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, e datës 16/10/2014, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti me përjashtim të çështjes që PVF nuk ishin përgatitur edhe në gjuhën serbe. Nevoja për ta adresuar këtë situatë është e reflektuar në memorandumun tonë të veçantë për Stafin Financiar.

Megjithatë, në PVF fillestare kishte pasur nevojë që të bëheshin disa korrigjime financiare.

**Çështja 3 - Mangësi dhe keq prezantim i informatave në PVF - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Për shkak të procesit joefektiv të rishikimit nga Menaxhmenti, të aplikuar në PVF:

- Buxheti final neni 13 ishte prezantuar gabimisht për 683,421€ më pak se shifra e saktë;
- Të arkëtueshmet ishin nënvlerësuar për 66,539€; dhe
- Donacionet e pranuar prej 8,000€ nuk ishin prezantuar saktë në kolonën e duhur në pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit.

Po ashtu, ne kemi dhënë një numër sugjerimesh për t'i përmirësuar shënimet shpjeguese aty ku PVF-të nuk ishin tërësisht konsistente me shifrat e prezantuara në pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme dhe ekzekutimit të buxhetit. Në veçanti, kjo kishte të bëjë me shifrat krahasuese të 2013 dhe 2012.

Edhe pse ishin bërë korrigjimet e përmendura më lartë, PVF ende përmbajnë gabime materiale si:

Keq klasifikim i shpenzimeve ishte 579,923€ ku nga kategoria investime kapitale ishin paguar mallra/shërbime dhe subvencione; dhe

Në totalin e pagesave më sipër, ishin bërë pagesa të parregullta në vlerë 445,000€ nga kategoria investime kapitale sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit. Për më tepër, referoju kapitullit 4.4.2.

**Rreziku** PVF-të që nuk i nënshtrohen një rishikimi të nivelit të duhur të Menaxhmentit, potencialisht mund të kenë gabime materiale të cilat mund të çojnë në opinion të modifikuar.

**Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë që plani i hartimit të PVF 2015 të përfshijë rishikimin në hollësi të draft llogarisë nga Menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse në të gjitha draft PVF-të janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme duke përfshirë këtu edhe një rishikim të dytë të pavarur të punës së ZKF-së.

### 3 Rekomandimet e vitit paraprak

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Edhe pse rekomandimet e më hershme të auditimit janë shqyrtuar, shumica prej tyre duhet të zbatohen plotësisht.

#### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit të Komunës së Suharekës për PVF-të e vitit 2013 të komunës së Suharekës ka rezultuar në 17 rekomandime dhe Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, tetë (8) rekomandime ishin adresuar plotësisht, katër (4) ishin adresuar pjesërisht dhe pesë (5) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

#### Çështja 4 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Edhe pse pjesa më e madhe e rekomandimeve janë trajtuar, vetëm gjysma e tyre janë adresuar plotësisht sepse komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces efektiv për ta menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP sipas planit të veprimit.
- Rreziku** Mos adresimi i dobësive të vazhdueshme të kontrolleve të Menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe kanë rezultuar në:
- Keq-klasifikime të vazhdueshme materiale të shpenzimeve në PVF dhe regjistër jo të plotë të pasurive në PVF;
  - Nivel të ulët të mbledhjes së të hyrave; dhe
  - Jo-efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe vlerë të dobët për para, të arritur përmes prokurimit;
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Kur raporti i ZAP-it të diskutohet në kuvend komunal, kryetari duhet t'i shtrojë barrierat për mos implementimin e plotë të rekomandimeve dhe asambleja duhet të sfidojë barrierat e mos implementimit të rekomandimeve dhe të kërkoj raporte të rregullta dhe të detajuara për progresin e implementimit të rekomandimeve.

## 4 Qeverisja

### Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes që mund të adresohen nga Komuna janë si në vazhdim:

- Vetëvlerësimi - edhe pse është zbatuar nga Komuna ka mundur të jetë më kritik si një pikënisje për të përmirësuar performancën e saj aty ku shihet e nevojshme;
- Menaxhimi i rrezikut - komuna ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës, që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen objektivave të komunës;
- Raportim efektiv ndaj Menaxhmentit i cili duhet të jetë më i formalizuar; dhe
- Auditimi i brendshëm - aty ku kërkohet rishikim i brendshëm më kritik për të siguruar që është arritur më shumë ndikim nga raportet e AB-së.

Si të tilla, aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes kërkojnë forcim. Po ashtu, ne kemi identifikuar që kontrollet mbi të hyrat dhe kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për parandalojë dhe menaxhim jo efektiv të projekteve kapitale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: prokurimi, planifikimi dhe realizimi i buxhetit, monitorimi efektiv i subvencioneve. Megjithatë, komuna e ka adresuar në mënyrë aktive reduktimin e buxhetit për 15% që ka të bëjë me mallrat dhe shërbimet dhe raporti i auditimit të jashtëm nga viti i kaluar është diskutuar në asamblenë komunale.

## 4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

### Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>12,594,079</b>	<b>14,031,421</b>	<b>12,948,970</b>	<b>12,719,099</b>	<b>12,155,556</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	10,676,977	11,720,010	11,511,488	10,286,473	9,969,500
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup> -	0	385,768	242,814	1,215,673	547,088
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	1,917,102	1,917,102	1,194,668	1,216,459	1,609,666
Donacionet e brendshme	0	465	0	0	5,000
Donacionet e jashtme	0	8,076	0	494	24,302

Buxheti final është për 1,437,341€ më i lartë se buxheti fillestar. Kjo rritje, kryesisht është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak dhe i një rritjeje të buxhetit në harmoni me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2014, komuna ka shfrytëzuar 92% të buxhetit final ose 12,948,970€, një nivel i ngjashëm me vitin 2013 (93%). Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm në fusha specifike dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>12,594,079</b>	<b>14,031,421</b>	<b>12,948,970</b>	<b>12,719,099</b>	<b>12,155,556</b>
Pagat dhe Mëditjet	6,100,000	7,214,219	7,061,677	6,052,770	6,041,205

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake komunale për vitin aktual të planifikuara dhe të shpenzuara.



## 4.1 Qeverisja e mirë

### Përshkrim

Qeverisja ka të bëjë me sistemin me të cilin organizatat menaxhohen dhe kontrollohen. Një qeverisje efektive kërkon planifikim të fortë, aranzhime të monitorimit dhe raportimit të cilat adresojnë rreziqe operative dhe strategjike më të cilat ballafaqohet një organizatë.

### Çështja 5 - Aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes - Prioriteti i lartë

<b>E gjetura</b>	<p>Disa aspekte të qeverisjes së mirë nuk kanë funksionuar në Komunë.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Mbështetja në komunikim joformal ka çuar në një raportim i cili nuk e demonstroi shqyrtimin e sfidave kyçe operative dhe përgjigjen ndaj këtyre. Kjo është edhe arsyeja pse ne nuk jemi mbështetur në kontrollet e raportimit të Menaxhmentit (si pjesë e qasjes sonë të auditimit); dhe</li><li>• Kërkesat për të aplikuar vetëvlerësimin dhe hartimin e regjistrit të rreziqeve janë adresuar vetëm pjesërisht, pasi rëndësia e këtyre si mjete për ta mbështetur menaxhimin efektiv nuk përdoret gjitha nga Komuna. Nuk ka të vendosur regjistër formal të rrezikut apo procese të menaxhimit të rrezikut dhe vetëvlerësimi nuk është bërë në një nivel të mjaftueshëm të rishikimit.</li></ul>
<b>Rreziku</b>	<p>Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi i cilësisë së dobët, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit operativ dhe financiar brenda komunës dhe potencialisht mund të rezultojnë me humbje financiare.</p>
<b>Rekomandimi 5</b>	<p>Kryetari duhet të bëjë rishikim të rregullimeve ekzistuese të qeverisjes/llogaridhënies dhe të kërkesave shoqëruese të raportimit në Komunë. Kërkesat e pazbatuara duhet të zbatohen deri në shtator 2015. Cilësia e çështjeve që ndërlidhen me këtë, si raportimi i brendshëm, duhet të rishikohen në mënyrë kritike për të demonstruar në Kuvendin Komunal që është aplikuar sfida efektive tek/nga zyrtarët për të siguruar një menaxhim efektiv operativ të Komunës dhe arritjen e objektivave strategjike.</p>

## 4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

### Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>12,594,079</b>	<b>14,031,421</b>	<b>12,948,970</b>	<b>12,719,099</b>	<b>12,155,556</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	10,676,977	11,720,010	11,511,488	10,286,473	9,969,500
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup> -	0	385,768	242,814	1,215,673	547,088
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	1,917,102	1,917,102	1,194,668	1,216,459	1,609,666
Donacionet e brendshme	0	465	0	0	5,000
Donacionet e jashtme	0	8,076	0	494	24,302

Buxheti final është për 1,437,341€ më i lartë se buxheti fillestar. Kjo rritje, kryesisht është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak dhe i një rritjeje të buxhetit në harmoni me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2014, komuna ka shfrytëzuar 92% të buxhetit final ose 12,948,970€, një nivel i ngjashëm me vitin 2013 (93%). Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm në fusha specifike dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>12,594,079</b>	<b>14,031,421</b>	<b>12,948,970</b>	<b>12,719,099</b>	<b>12,155,556</b>
Pagat dhe Mëditjet	6,100,000	7,214,219	7,061,677	6,052,770	6,041,205

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake komunale për vitin aktual të planifikuara dhe të shpenzuara.

Mallrat dhe Shërbimet	912,468	1,145,659	921,359	888,926	986,698
Shërbimet komunale	267,700	267,700	227,360	232,194	226,891
Subvencionet dhe Transferet	302,000	304,365	298,120	204,581	126,775
Investimet Kapitale	5,011,911	5,099,478	4,440,454	5,340,628	4,773,987

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes në buxhetin për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 87% e buxhetit ishte shpenzuar, pjesërisht për shkak të transferimit të 221,040€ tek Mallrat dhe Shërbimet për ta adresuar 15% të reduktimit të buxhetit në atë fushë dhe detyrimeve të vitit paraprak. Kjo rritje, po ashtu, reflekton edhe vonesat në përfundimin e projekteve dhe disa vonesave në procedurat e prokurimit si pasojë e mungesës të mjeteve financiare nga të hyrat vetjake;
- Ekzekutimi i buxhetit për mallra dhe shërbime ishte vetëm 80% por duke e pasur parasysh mos alokimin e 15% të buxhetit, shkalla e vërtetë e ekzekutimit është 85%. Kjo ndodhi kryesisht për shkak të mos realizimit të planit të pritur të mbledhjes së të hyrave vetjake për t'i mbështetur këto shpenzime;
- Realizimi i buxhetit të pagave dhe mëditjeve në vitin 2014 është 92% - një gjendje e ngjashme edhe me vitin 2013 edhe pse kjo pjesërisht e reflekton ngritjen e pagave për 25% të zbatuar në prill 2014, gjë që nuk është reflektuar në buxhet. Kjo e reflekton mbivlerësimin e kërkesave të pagave dhe mëditjeve gjatë procesit të buxhetit; dhe
- Komuna ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët e jashtëm në shumë 8,076€, mirëpo të cilat nuk ishin alokuar dhe shpenzuar gjatë vitit 2014 për shkak të vonesave në alokimin e tyre, por që janë bartur në vitin 2015.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Komunës - ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetanake	1,917,102	1,917,102	1,632,052 <sup>4</sup>	1,453,778	2,906,049

Plani i të hyrave për 2014 ishte realizuar 85% me një rritje prej 3% krahasuar me realizimin e vitit 2013. Një suficit kumulativ prej 580,452€ i të hyrave vetjake nga viti 2014 dhe vitet më hershme, është bartur në vitin 2015.

<sup>4</sup> Kjo shumë përfshinë edhe 145,716€ të hyrat nga dënimet e trafikut dhe 142,324€ të hyrat nga dënimet e gjykatave

**Çështja 6 - Planifikim i dobët dhe realizimi i ulët i buxhetit - Prioriteti i Lartë**

- E gjetura** Edhe pse Komuna i ka bërë disa ndryshime buxhetore gjatë vitit 2014, kërkesat e përgjithshme të buxhetit për shpenzime nuk janë përcaktuar në mënyrë adekuate dhe ngjashëm projeksonet e të hyrave janë joreale.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët i buxhetit do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe e shtyj shlyerjen e detyrimeve të vitit aktual tek buxheti i vitit të ardhshëm, duke e reduktuar mundësinë për t'i arritur objektivat e ardhme të komunës. Kjo, po ashtu, demonstron edhe nga niveli i suficitit domethënës i të hyrave vetjake që do të barten në vitin 2015.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të siguroj se performanca buxhetore monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për t'i përmirësuar nivelin e realizimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të rishikohet në buxhetin final.

### 4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

**Përshkrimi**

Të hyrat e gjeneruara nga komuna gjatë vitit 2014 në total ishin 1,632,052€. Këto kishin të bëjnë kryesisht me tatimin në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiratë dhe të hyrat nga taksa administrative.

**Çështja 7 -Tatimi në pronë - Prioriteti i mesëm**

- E gjetura** Tatim paguesit e ri nuk ishin identifikuar dhe futur gjithmonë me kohë në sistemin e tatimit në pronë. Një tatim pagues afarist kishte filluar afarizmin gjatë vitit 2013 mirëpo vonesa për ta regjistruar në sistem ka rezultuar me humbje financiare në vlerë prej 5,000€, për shkak se të hyrat e tatimit në pronë nuk mund të faturohen në mënyrë retroaktive;
- Komisioni i shqyrtimit të ankesave në Njësinë e Tatimit në Pronë nuk kishte një përbërje të duhur, sepse dy nga tre anëtarët ishin punonjësit e njësisë së tatimit në pronë. Kjo kishte ndodhur sepse kërkohet ekspertizë nga anëtarët e komisionit, mirëpo është në kundërshtim me legjislacionin ekzistues - "Udhëzimi administrativ për ankesat në tatimin në pronë të paluajtshme".
- Rreziku** Mos identifikimi dhe regjistrimi i vonshëm i pronave të reja në sistemin e tatimit në pronë rezultojn me humbje financiare për komunën. Anëtarët jo adekuat të komisionit, mund të rezultojnë në konflikt të interesit dhe marrëveshje të fshehta dhe ankesat të rezultojnë me vendime subjektive.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të sigurojë që proceset e brendshme forcohen për të lejuar regjistrim të menjëhershëm dhe faturim të pronave të reja duke raportuar te Menaxhmenti për pikat kyçe të këtij procesi. Duhet të kihet në konsideratë edhe kontrollet e nevojshme që duhet implementuar për t'u siguruar se janë aplikuar plotësisht të gjitha udhëzimet administrative dhe kjo duhet të monitorohet vazhdimisht.

#### Çështja 8 – Të hyrat nga qiratë - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Ligjet ekzistuese kërkojnë që pasuritë komunale të dhëna me qira që u ka skaduar afati, të ofrohen në ankand të hapur. Kjo nuk është bërë nga komuna nën hijen e kushteve të vështira ekonomike më të cilat ballafaqohen qiraxhinjtë e saj.
- Për më shumë, niveli i arkëtimit për të hyrat nga qiratë mbetet i vogël. Buxheti për 2014 ishte 240,000€ ndërsa vetëm 43% e buxhetit ishte realizuar. Masa minimale janë ndërmarrë nga komuna për të mbledhur këto të hyra, duke rezultuar me një rritje të lartë të të arkëtueshmeve prej 351,000€. Shih pjesën 4.5.2
- Rreziku** Mos vënia e qirave të skaduara në ankand të hapur e redukton potencialin për rritje të të hyrave të komunës. Ngjashëm, procedurat e dobëta të inkasimit të të hyrave e zvogëlojnë mundësinë e Komunës në arritjen e objektivave të shpenzimit.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë se janë përmbushur kërkesat ekzistuese ligjore me të gjitha kontratat e skaduara të ofruara në ankand të hapur. Ky proces duhet të monitorohet dhe të raportohet tek Kuvendi Komunal. Përveç kësaj, masa të nevojshme të inkasimit duhet ndermirën për maksimizuar nivelin e inkasimit.

### 4.4 Shpenzimet

#### 4.4.1 Prokurimi

##### Përshkrimi

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë që fondet publike aplikohen në mënyrë transparente dhe eficiente për të arritur vlerën për paranë. Korniza ligjore qartazi definojnë drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë palëve të përfshira në prokurimin publik. Kjo përfshinë kërkesat për të zbutur rreziqet sa i përket vonësive në kryerjes së punëve, shmangien e konfliktit të interesave, ofertave të pa plota dhe arritjen e vlerës për para.

Gjithsej 207 procedura të prokurimit ishin zbatuar në vitin 2014, përfshirë edhe ato të anuluarat (vlera 2,483,118€), prej të cilave 9 (nëntë) raste të prokurimit në shumë prej 153,963 nuk janë planifikuar në planin e prokurimit.

---

**Çështja 9 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë**

	<p>Nga shqyrtimi i 12 kontratave ne kemi identifikuar një sërë dobësish të përbashkëta.</p>
<b>E gjetura</b>	<p><b>Konflikt interesi ndërmjet shërbimeve konsulente dhe prokurimit të mallrave dhe shërbimeve</b></p> <p>Komuna i kishte dhënë 2 kontrata të njëjtës firmë për Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative në vlerë prej 25,000€ (procedurë e hapur), ndërsa kontrata e dytë për shërbime konsulente për mirëmbajtjen e TI, ueb faqes dhe telekomunikimit të brendshëm - 9,000€ (kuotim çmimi); Kjo është në kundërshtim me ligjin e prokurimit. Megjithatë, kjo çështje është adresuar gjatë kohës kur ne ishim në auditim.</p> <p>Në katër procedura të prokurimit "Ndërtimi dhe meremetimi i trotuareve në komunë"; "Ndërtimi i rrugëve lokale në Leshan"; "Furnizim i bujqve me inpute bujqësore" dhe "Rregullimi i oborrit në shkollën fillore në Budakovë" kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave ishte njëkohësisht edhe organ mbikëqyrës i të njëjtave projekte dhe kishte aprovuar punët e kryera. Kjo është jo në pajtim me udhëzuesin operativ për prokurim publik, pasi paraqet konflikt interesi;</p> <p>Këta shembuj reflektojnë kuptim dhe zbatim të dobët të kërkesave të prokurimit nga Komuna.</p>

---

**Tejkalimi i procedurave të shpenzimeve për blerje të parapara me rregullat financiare dhe SIMFK**

Procedurat e parapara të shpenzimit të parasë për mallra dhe shërbime brenda çfarëdo kontrate në këtë fushë nuk ishin zhvilluar gjithmonë në pajtim me rregullat financiare. Ne kemi gjetur se pasi ishin pranuar mallrat ose shërbimet, pastaj ishin iniciuar procedurat e nevojshme si: kërkesa për blerje, zotimi, urdhër blerja dhe raporti i pranimit të mallrave ose shërbimeve. Dukuri të ngjashme, megjithëse në masë më të vogël, ishin vërejtur edhe tek pagesat për investime kapitale. Këto kishin ndodhur për shkak të mos aplikimit të rregulloreve të brendshme.

**Vlerësim i dobët i nevojave**

9 prokurime prej 153,963€ nuk janë përfshirë në planin e prokurimit fillestar të dërguar te Agjencia Qendrore e Prokurimit, për shkak të planifikimit joadekuat dhe dallimit në mes të prokurimeve fillestare të planifikuara dhe nevojave.

**Rreziku**

Mos ndjekja e procedurave të duhura të prokurimit mund të rezultojë në vlerë të dobët për para dhe humbje financiare nga prokurimi si rezultat i zbatimit të dobët të rregulloreve. Mos planifikimi adekuat i prokurimeve mund të rezultojë në procedura joefikase të prokurimit dhe vlerë të dobët për para.

**Rekomandimi 9**

Kryetari duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe të zbatojë kontrolle të shtuara për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuara janë adresuar.

**Çështja 10 - Dobësi jo sistematike të prokurimit- Prioritet i mesëm**

- E gjetura** Specifikacioni teknik për furnizim me pajisje teknologjisë informative nuk përkonte me nevojat reale të komunës, ngase pajisjet e furnizuara nuk ishin kërkuar/miratuara nga drejtorët e drejtorive. Një analizë e blerjeve të pajisjeve për TI ka treguar se furnizimet për TI ishin bërë me çmime shumëfish më të shtrenjta kundrejt çmimeve të tregut. Operatori fitues ka ofruar pajisje të specifikave të larta për vetëm 5€, prej të cilave asnjë nuk është blerë, ndërsa janë blerë ato me performanca më të ulëta me çmime deri në 490€. Kjo praktikë ishte e shprehur në më shumë raste për blerjet e pajisjeve të TI. Kjo ka ndodhur për shkak kontrolleve të dobëta të prokurimit dhe Menaxhmenti nuk kishte shpjegime pse praktika të tilla janë zbatuar.
- Rreziku** Kontratat e pa specifikuara qartë dhe kontratat e miratuara me çmime të dyshimta, në mënyrë domethënëse rrisin rrezikun për mashtrim dhe marrëveshje të fshehta në mes të stafit dhe furnizuesve. Po ashtu, kjo rezultoi me humbje të konsiderueshme financiare për komunën.
- Rekomandimi 10** Kryetari duhet të shqyrtojë pse janë aplikuar praktika të dobëta të prokurimit në këtë rast dhe të zbatojë kontrolle të shtuara të cilat sigurojnë se: prokurimet i reflektojnë nevojat; specifikacionet e tenderit i reflektojnë kërkesat aktuale; dhe, furnizimet i reflektojnë kërkesat e drejtorive.

**4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit**

**Përshkrim**

Shpenzimet jo përmes prokurimit janë shpenzimet për të cilat nuk aplikohen procedurat e prokurimit. Ato kanë të bëjnë me komunalitet, shpenzimet e udhëtimit dhe pagesat me bashkëfinancim.

**Çështja 11 -Pagesa bazuar vetëm në marrëveshje të mirëkuptimit- Prioriteti i lartë**

- E gjetura** Marrëveshjet për bashkëfinancim janë menaxhuar dhe monitoruar dobët pasi që fokusi i Komunës është në sigurimin e fondeve të jashtme dhe rrjedhimisht memorandumet e mirëkuptimit janë të dobëta. Për shembull:
- Është arritur bashkëfinancimi me Organizatën Jo Qeveritare Kosovo Partners me qëllim të transportit të nxënësve të disa shkollave fillore në relacionin shkollë-shtëpi dhe anasjelltas. Marrëveshja ishte financuar 24,900€ nga komuna dhe 5,000€ nga Kosovo Partners. Mjetet financiare i ishin dhënë OJQ në mungesë të faturave dhe raporteve të kryerjes së shërbimeve. Përkundër që pjesa dërmuese e fondeve (83%) ishte financuar nga komuna, nuk ishin zhvilluar procedura të prokurimit për shpenzimin e këtyre mjeteve nga komuna, gjë që është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) Neni 4, paragrafi 2 i cili kërkon që Komuna ta udhëheqë prokurimin aty ku kontributi i tyre e tejkalon 50%;
- Një pagesë prej 16,000€ i ishte bërë OJQ Kosova Hope bazuar në një marrëveshje mirëkuptimi që arrinte 61,000€ e cila ishte financuar nga komuna me 26,000€ dhe 35,000€ nga OJQ. Pagesa prej 16,000€ ishte bërë në mungesë të faturave dhe dëshmime të duhura;
- Dy pagesa në formë të subvencionimit nga 4,320€ secila i shin bërë OJQ-së Care International për të implementuar Programin e Profesionistëve të Rijnë në projektin Integrimi Regjional për Zhvillim në sektorin e bujqësisë, në mungesë të faturave dhe dëshmime për kryerjen e punëve;
- Bashkëfinancimi me Caritas Kosova për "Përkujdesje shëndetësore shtëpiake -shtretërit shtëpiak -Home Care III" prej 210,000 € kërkonte 160,000€ financim nga Komuna. Të gjitha pagesat për këtë marrëveshje ishin bërë nga investimet kapitale, edhe pse shpenzimet nuk kishin të bënin me shpenzime kapitale. Edhe pse komuna kishte financuar 76% të projektit, të gjitha procedurat e rekrutimit të stafit mjekësor dhe teknik dhe ato të prokurimit ishin zhvilluar nga Caritas Kosova. Pagesat nuk ishin të mbështetura me dëshmi të detajuara rreth punëve të kryera siç kërkohej me marrëveshje dhe rregulloret tjera të shpenzimit të parase publike.
- Rreziku** Si rezultat i procedurave të dobëta të kontrollit dhe mos pajtueshmërisë me kërkesat legjislative, kostot e paguara nga Komuna mund të jenë më të mëdha se sa është e nevojshme dhe mundet që objektivat e shpenzimeve të mos përmbushen. Këto mund të konsiderohen pagesa potencialisht të parregullta.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet t'i rishikojë të gjitha marrëveshjet ekzistuese për bashkëfinancim për të përcaktuar pse nuk janë përmbushur kërkesat ligjore dhe të shikojë ta rregullojë pozicionin si një çështje urgjente. Të gjitha marrëveshjet e mirëkuptimit duhet të azhurnohen për të siguruar transparencë dhe mekanizma efektiv monitorues për të dhënë siguri se kontributet e Komunës sigurojnë vlerë për parandë, po shpenzohen sipas qëllimit dhe po mbështeten nga dëshmitë adekuate.

#### 4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

##### Përshkrimi

Shpenzimet e kompensimi në total ishin 7,061,677. Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave si aprovimi dhe futja në listë të pagave të punonjësve të rinj, verifikimi i numrit të lejuar dhe kontrollat tjera shoqëruese kryhen nga Ministria e Administratës Publike. Aprovimi i buxhetit për paga dhe mëditje bëhet nga asambleja komunale e aprovimi i shitesave apo ndryshimeve të nevojshme dhe nënshkrimi i listave të pagave nga menaxheret përkatës të komunës. Puna e ndërmarrë nga ne përfshinte testimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshme, testet substanciale dhe procedura të pajtueshmërisë.

Ne nuk kemi identifikuar ndonjë çështje domethënëse për paga dhe mëditje.

##### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

#### 4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

##### Përshkrimi

Subvencionet kryesisht u ndahen entiteteve publike dhe jo publike dhe personave fizik në nevojë. Kontrollat e operuara nga komuna përcaktohen me rregulloren e brendshme dhe udhëzimet e përgjithshme të shpenzimit të parasë publike.

---

**Çështja 12 -Monitorim i dobët dhe mungesa e raportimeve financiare kthyesë - Prioritet i mesëm**

- E gjetura** Rezultati/ndikimi i subvencioneve jo gjithmonë ishin monitoruar dhe raportuar tek Menaxhmenti. Në tre nga pesë rastet e shqyrtuara, raportet narrative financiare të përfituesve nuk mbështeteshin nga dëshmitë relevante. Asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë për të siguruar këto raporte. Këto ishin për Shoqëria kulturore artistike "Jehona" nga Suhareka në shumë 1,200€; Shoqata për Art dhe Kulturë "Elena Gjika" në shumë 2,570€; dhe OJQ "Vala" në shumë 2,200€.
- Rreziku** Dështimi për të nxjerrë informata adekuate të monitorimit mund të rezultojë në mosarritjen e objektivave të subvencioneve dhe pagesa të parregullta.
- Rekomandimi 12** Kryetari të sigurojë se të gjitha subvencionet janë subjekt i monitorimit efektiv duke i përcaktuar kërkesat për raportim të përfituesve për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve në vendimet për subvencionim. Aty ku kërkesat nuk respektohen masa adekuate duhet të ndermirën, si suspendimi i pagesave.

## 4.5 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat e validizojnë ekzistencën e pasurive ekzistuese dhe sigurojnë të dhëna të azhuruara në pajtueshmëri me pasuritë e reja dhe ndryshimet tjera.

Të gjitha çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar në seksionin 2.2 Rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare.

### 4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

#### Përshkrim

Llogaritë e Arkëtueshme janë detyrime në mjete financiare që të tjerët i kanë ndaj komunës. Në fund të vitit 2014 ato ishin 4,212,000€ një rritje prej 11.5% nga viti 2013. Këto kryesisht

---

kanë të bëjnë me tatimin në pronë 2,108,000€; taksat komunale 1,686,000€; c) qiraja 351,000€ dhe lejet e ndërtimit 66,539€.

---

**Çështja 13 - Nivel i lartë i Llogarive të Arkëtueshme dhe mungesa e strategjive dhe veprimeve për mbledhjen e tyre -Prioritet i lartë**

- E gjetura** Edhe pse Llogaritë e Arkëtueshme ishin rritur nga vitet e mëhershme, komuna nuk ka hartuar ndonjë strategji praktike për mbledhjen e borxheve të saj, e as nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për t'i nxitur pagesat. Përderisa niveli i arkëtimit tek tatimi në pronë dhe lejet e ndërtimit qëndron relativisht mirë, tek pjesa tjetër, arkëtimi mbetet relativisht i ulët me, vetëm 43% e buxhetit të vitit 2014 është realizuar për të hyrat nga qiratë ndërsa 64% për taksat komunale.
- Rreziku** Një qasje joefektive në mbledhjen e borxhit do të rezultojë me humbje financiare për Komunën; i zvogëlon mundësitë e investimit; dhe paraqet precedent të keq ku mos pagesat mund të bëhet normë.
- Rekomandimi 13** Kryetari të siguroj një shqyrtim rigoroz të të arkëtueshmeve për të përcaktuar çka mund të mblidhet dhe të aplikojë masat ligjore për maksimizimin e niveleve të inkasimit.

#### 4.5.3 Trajtimi i borxheve

##### Përshkrim

Komuna i ka zvogëluar obligimet e paguara nga 114,218€ sa ishin në vitin 2013 në 47,886€ në fund të vitit 2014. Megjithatë, suficiti prej 580,000€ i të hyrave vetjake të pa shpenzuara në vitin 2014 që janë bartur në vitin 2015 ka demonstruar një jo-efikasitet në menaxhimin e plotë të borxheve.

Procesi aktual i përdorur për raportimin e faturave të pa paguara nuk ofron siguri të mjaftueshme se të gjitha faturat e pa paguara nga departamentet tjera përcillen me kohë tek Zyrtari Kryesor Financiar për tu pasqyruar në raportet mujore të obligimeve dhe PVF. Aranzhimet e ZKF duhet të jenë më pro aktive për të konsoliduar plotësinë e obligimeve duke mos lënë vetëm në vullnetin dhe/ose neglizhencën e zyrtarëve për të përcjellë faturat e pa paguara tek departamenti i financave. Procesi aktual duhet të rishikohet për të siguruar raportim efektiv të obligimeve.

##### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë

---

## 4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij, ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

### Çështja 14 – Zbatim i dobët i rekomandimeve të NjAB-it - Prioritet i lartë

- E gjetura** Edhe pse Komiteti i Auditimit dhe Kryetari janë takuar 6 herë për t'i diskutuar raportet e Auditimit të Brendshëm, nuk u është dhënë rëndësi e duhur rekomandimeve dhe nuk janë zbatuar në mënyrë efektive. Kjo e ka reflektuar një mungesë të takimit të drejtorëve të drejtorive të audituara. Në këtë mënyrë, nuk ka ndikim të dukshëm të komitetit në adresimin e rekomandimeve apo përmirësimin e kontrolleve që operohen nga Komuna aty ku janë dhënë rekomandimet.
- Rreziku** Dështimi për të adresuar rekomandimet rrit rrezikun që dobësitë e identifikuara nga auditimi i brendshëm të mbesin të pa përmirësuara që mund të rezultojë me jo efikasitet të vazhdueshëm organizativ, humbje financiare për komunën dhe vlerë të dobët për para.
- Rekomandimi 14** Kryetari duhet të siguroj se arsytet për nivelin e ulët të adresimit të rekomandimeve të auditorit të brendshëm analizohen dhe të inicijoj përgatitjen e planeve të veprimit për adresimin e rekomandimeve, duke përfshirë kohën dhe stafin kyç përgjegjës. Komiteti i auditimit duhet ta monitorojë zbatimin e rekomandimeve, dhe aty ku është e nevojshme, të kërkojë shpjegime për moszbatim.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori

duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandi met plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandi met e pa adresuara
PVF	Kryetari duhet të sigurojë që plani i prodhimit të llogarive për vitin 2014 formalisht adreson të gjitha kërkesat për pajtueshmëri lidhur me PVF-të, me fokus të veçantë në fushat e theksuara më lartë. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF lidhur me saktësinë e PVF-ve nuk duhet të dorëzohet pa u siguruar se janë zbatuar të gjitha kontrollet relevante për PVF-të.		PVF janë korrigjuar në lidhje me pasuritë ... --por nuk janë ndërmarrë veprime në lidhje me pagesat e palëve të treta	X
PVF	Kryetari duhet të analizoj arsyet për keq deklarimet lidhur me pagesat nga palët e treta dhe të siguroj se pagesat nga palët e treta të raportohen në mënyrë të plotë dhe të saktë në PVF-të.	X		
Pasuritë	Kryetari duhet të identifikojë arsyet për keq deklarimin fillestar të pasurive dhe dështimin për ndjekur këshillat e ZAP. Procesi të duhura duhet të vendosen në vitin 2014 për të siguruar se asnjë projekt kapital i pa përfunduar, nuk do të regjistrohet si pasuri para se i njëjti t'i dorëzohet komunës.			Nuk janë ndërmarrë

Shpenzimet	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të kontrollit në klasifikimin e pagesave në kode ekonomike adekuatë, sipas buxhetit të aprovuar në bazë të kategorive dhe të planit kontabël.		X	
Adresimi i rekomandimëve nga viti i kaluar	Kryetari duhet të sigurojë se një plan i rishikuar, praktikisht njëkohësisht edhe sfidues, është hartuar për të adresuar rekomandimet e bëra nga Auditori Përgjithshëm, duke caktuar stafin përgjegjës me një fokus fillestar në fushat më të rëndësishme. Zbatimi i këtij plani duhet të rishikohet nga kryetari në baza mujore.	X		
Qeverisja e mirë	Kryetari duhet të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar përmes së cilës Menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato.			Kryedhat e informacionit nuk janë gjithmonë të dokumentuara dhe formale. Elemente të Qeverisjes së mirë si menaxhimi i rrezikut nuk janë në nivelin e duhur.
Ekzekutimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë se procesit të përgatitjes së buxhetit i paraprinë një rivlerësim rigoroz i procesit i cili pasqyron në mënyrë të plotë të gjitha informatat relevante, përfshirë lëvizjet e viteve të kaluara apo ndryshimet e pritura nëpër vite.			Pjesërisht sepse çështja e klasifikimit të shpenzimeve kërkon një planifikim më rigoroz që nuk është arritur.
Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që krahas përmirësimit të planifikimit, duhet të sigurojë se mekanizmat adekuat për mbledhjen e tatimit në pronë, janë në veprim dhe			X

	sigurojnë shikallën maksimale të inkasimeve.				
<b>Të hyrat</b>	Kryetari duhet të siguroj që dhënia e lejeve të ndërtimit të shqyrtohet si dhe të siguroj se të gjitha kërkesat që pasojnë në të ardhmen, të trajtohen në pajtim me kërkesat ligjore për dhënie e lejeve të ndërtimit.	X			
<b>Të hyrat</b>	Kryetari i komunës duhet të rishqyrtoj në Asamblenë komunale çështjen e kontratave të skaktuara, dhe aty ku e vlerëson të arsyeshme, të vazhdoj kohëzgjatjen e kontratave. Në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike për shfrytëzuesit që nuk posedojnë kontratat valide.				X
<b>Shpenzimet me prokurim</b>	Kryetari duhet të siguroj se shërbimi i prokurimit do të shqyrtoj me kujdes dhe kompetencë proceset e prokurimit dhe të siguroj se veprimet e ndërmarra janë në pajtim të plotë me rregullat e prokurimit. Në rastet kur kushtet nuk janë plotësuar, aktivitetet e prokurimit duhet të anulohen.	X			
<b>Shpenzimet me prokurim</b>	Kryetari të siguroj që stafi vlerësues është i pajisur me njohuri të nevojshme për të vlerësuar proceset e prokurimit dhe që sipas nevojës të organizohen trajnime për t'i mbajtur të përditësuar me kërkesat dhe ndryshimet e Legjislacionit.	X			
<b>Shpenzimet me prokurim</b>	Kryetari duhet të siguroj që janë vendosur kontrolle shtesë me rastin e çertifikimit të pagesave. Zyrtari	X			

	certifikues duhet të bëj certifikimin e pagesave vetëm pasi të jenë përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara me ligj, respektivisht pasi malli të jetë pranuar, dhe punët ose shërbimet të jenë kryer në pajtim me kontratat.	X			
<b>Prokurimi</b>	Kryetari duhet të siguroj një monitorim më efektiv të procesit të prokurimit përmes menaxherit të prokurimit, në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten.	X			
<b>Pasuritë kapitale dhe jo kapitale</b>	Kryetari duhet të siguroj që raporti i komisionit për vlerësim dhe inventarizim të pasurive është shqyrtuar dhe rezultatet e regjistrimit janë përditësuar në regjistrat e pasurive. Diferencat e regjistrimeve dhe regjistrave kontabël duhet të sqarohen, kurse pasuria e pa përdorshme, e tjetërsuar, e shitur apo jashtë përdorimit, duhet gjithashtu të trajtohet sipas Udhëzimeve mbi përdorimin e pasurisë qeveritare.				X
<b>Trajtimi i borxheve</b>	Kryetari duhet të siguroj kontrolle të vazhdueshme në procesin e mbajtjes së evidencave për obligimet e komunës në mënyrë që në PVF-të e komunës të shpaloset një gjendje e saktë dhe e plotë e obligimeve të komunës.	X			
<b>Sistemi i auditimit të brendshëm</b>	Kryetari duhet të funksionalizoj komitetin e auditimit dhe të siguroj që çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm të adresohen nga Menaxhmenti në mënyrë që gabimet dhe parregullsitë të zvogëlohen.			Pjesërisht sepse Komiteti i Auditimit nuk ka ndërmarrë ndonjë masë për të ndihmuar në adresimin e rekomandimeve.	
<b>Përmbledhje</b>	Gjithsejtë 17rekomandime	8	4		5

